



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:202209

Datë: 31.05.2024

Numri i dokumentit: 05762020

Ac.nr.8455/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, me gjyqtarin Naim Mehulli, në një çështjen juridike përmbarimore të kreditorit A.S. nga F....., të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Besmir Rrahmani avokat nga Ferizaj, kundër debitorëve: E.I., nga fsh....., F....., E.I.2., nga F.....dhe “COCO CLUB” sh.p.k., me seli në Ferizaj, të cilët i përfaqëson me autorizim avokat Fitim Shabani nga Ferizaj, lidhur me çështjen përmbarimore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të debitorëve, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.211/22, i datës 11.11.2022, me datë 31.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e autorizuarit të debitorëve: E.I., nga fsh....., F....., E.I.2., nga F.....dhe “COCO CLUB” sh.p.k., me seli në Ferizaj, dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.211/22 i datës 11.11.2022 dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar PPP.nr.211/2022 të datës 11.11.2022 ka nxjerrë dispozitivin si në vijim:

REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorëve: debitorëve: E.I., E.I.2.dhe “COCO CLUB” sh.p.k., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarimit P.nr.314/2022 i datës 20.09.3033, i lëshuar nga përmbaruesi privat Sheremet Livoreka nga Ferizaj dhe MBETET në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.314/2022 i datës 20.09.2022.

Kundër këtij aktvendimi i autorizuari i debitorëve brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë pa specifikuar shkaqet e ankesës, me propozim që të anulohet aktvendimi i atakuar, ngase i njëjti është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur nga pala e kreditorit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), ka gjetur se:

Ankesa e autorizuarit të debitorëve është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, në bazë të dokumentit përmbartimor aktit noterial për shitblerjen e aksioneve LPR.nr.14201/2022 nr. referencës 5349/2022 e datës 14.06.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim me dt.20.09.2022, me të cilën obligohen debitorët e përmbartimit që menjëherë nga dita e pranimi të këtij urdhri të paguajnë shumën prej 20.000 €, pasi nga marrëveshja e lartcekur debitori ka marr për obligim t ia pagan kreditorit A.S. në emër të borxhit- shitjes së aksioneve në shumën e përgjithshme prej 35,000 euro, nga e cila vlerë 5,000.00 euro ti paguajnë më së largu me datë 20.07.2022, përmes transferit bankar, 20,000.00 euro kanë pasur ti paguajnë më së largu me datë 22.08.2022 përmes transferit bankar, ndërsa vlera e mbetur prej 10,000.00 euro më së largu me datë 05.01.2023, debitorët deri me datën e këtij propozimi kanë paguar vetëm pjesën e parë prej 5,000.00 euro, kurse ratën e dytë prej 20,000.00 euro që tash më ka arritur afatin e pagesës e nuk e kanë paguar.

Përmbartuesi Privat duke vepruar sipas propozimit të kreditorëve të datës 20.09.2022, ka nxjerrë Urdhrit Përmbartimor me shenjë P.nr.314/22 i datës 20.09.2022, me të cilën e ka lejuar përmbartimin sipas dokumentit përmbartimor aktit noterial për shitblerjen e aksioneve LPR.nr.14201/2022 nr. referencës 5349/2022 e datës 14.06.2022, duke e pranuar si dokument përmbartimor, e cila i plotëson kushtet për ta lejuar përmbartimin.

Kundër Urdhrit Përmbartimor i autorizuari i debitorëve ka paraqitur prapësim me datën 22.09.2022, me propozim që të: aprovohet në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorëve ndërsa urdhri përmbartimor i përmbartuesit privat për lejimin e propozimit për përmbartim të kreditorëve dhe caktimin e zbatimit të përmbartimit të refuzohet dhe detyrohet kreditori që debitorëve t'ua kompensojë të gjitha shpenzimet e procedurës përmbartimore, në emër të këtij prapësimi në shumë prej 156 euro.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimi, me aktvendimin e atakuar PPP.nr. 211/2022, i datës 11.11.2022, ka vendosur që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorëve, i ushtruar kundër Urdhrit mbi lejimin e përmbartimit, P.nr.314/2022, i datës 20.09.2022, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se: se në këtë çështje përmbartimore urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentit përmbartimor aktit noterial, dokumentit për shitblerjen e aksioneve LPR.nr.14201/2022 nr. referencës 5349/2022 e datës 14.06.2022, në bazë të së cilave debitorët kanë qenë të obliguar që të paguajnë ratën e dytë në shumë prej 20,000.00 euro, por një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe kreditori për këtë shkak dhe ka bërë propozim për përmbartim. Në prapësimin e debitorëve është pretenduar se të njëjtit nuk kanë dashur ti ikin obligimeve, por për shkak të disa problemeve financiare nuk kanë mundur të shtyjnë afatin kohor, e që në bazë të marrëveshjes së krijuar mes palëve, në nenin 11 palët janë dakorduar që në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje, e njëjta të zgjidhet me një konsultim miqësor brenda 30 ditëve. Sipas gjykatës së shkallës së parë këto pretendime nuk qëndrojnë ngase të njëjtat janë pjesë e grupit të shkaqeve të

prapësimi që përmenden në nenin 71 të Ligjit për Procedurë Përmbartimore. Përpos kësaj, debitori ka ushtruar propozimin për përmbartim pas kalimit të afatit kohor brenda të cilit debitorët kishin për detyrë të paguanin ratën e dytë prej 20,000.00 euro.

Më tutje, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se dokumenti noterial në të cilin është propozuar përmbartimi është në pajtim të plotë me nenin 22 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LPP-së, ku është paraparë se: “. dokumenti noterial i përmbartueshëm në pajtim me ligjin për noterinë; “. Kjo vërtetohet dhe duke u bazuar në nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Noterinë, ku përcaktohet se: “Dokument i noterial është dokument përmbartimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përmbartimi i detyrueshëm.”

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të atakuar, Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për shkak se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5, dhe 175 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), si dhe lidhur me nenin 22 paragraf 1, pika 1.3, 26 paragraf 1 dhe 36 paragraf 1, 2 dhe 3 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore (LPP).

Aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4 dhe 5, dhe 175 të LPK-së, sepse dispozitivi i aktvendimit është në kundërtënie me arsyet e aktvendimit dhe për faktet vendimtare, aktvendimi nuk përmban arsye për mënyrën e vendosjes. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur dispozitave të cituara për arsyetimin e aktvendimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Me nenin 21 të LPP-së, përcaktohet se: “ Organi përmbartues e cakton, e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm po që se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër ”.

Me nenin 22 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së, përcaktohet se: “ Dokumenti noterial i përmbartueshëm në pajtim me ligjin për noterinë ” dhe përbën bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas neni 21, duke i plotësuar kushtet nga neni 27 paragrafi 1, i këtij ligji, ku përcaktohet se: “ Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit ”.

Me nenin 26 paragraf 1 të LPP-së, përcaktohet se: “ Dokumenti i noterizuar është i përmbartueshëm nëse është bërë i përmbartueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbartueshmërinë e atij dokumenti ”, ndërsa me paragraf 2, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Përmbartimi në bazë të dokumentit të noterizuar që është bërë i përmbartueshëm për ndonjë pjesë, mund të urdhërohet vetëm për atë pjesë ”.

Me nenin 36 paragraf 1 të LPP-së, përcaktohet se: “ Së bashku me propozimin për përmbartim, organi përmbartues i dorëzohet edhe dokumenti përmbartues origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbartueshmërisë për përmbartueshmëri ”, me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “ Vërtetimin për përmbartueshmërinë e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë ”, ndërsa me paragrafin

3, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Përfundimisht nga dispozitat e paragrafit 1 dhe 2, të këtij neni, dokumenti përbarimor i noterit, në bazë të cilit është paraqitur propozimi për përbarim, nuk ka nevojë të jetë i pajisur me vërtetimin për përbarueshmërinë, por përbarueshmëria e tij përcaktohet sipas dispozitave të ligjit për noterinë ”.

Me nenin 43 paragraf 1 të Ligjit për Noterinë, (Ligji nr.06/L-010 i datës 23.11.2018), përcaktohet se: “ Dokumenti noterial është dokument përbarimor në qoftë se është përpiluar në formën e paraparë dhe nëse në të është përcaktuar kryerja e detyrimit të caktuar për të cilën palët mund të merren vesh dhe nëse përmban deklaratën e detyruesit për atë që në bazë të atij dokumenti, mundet, e me qëllim të realizimit të detyrimit, pas arritshmërisë së detyrimit, në mënyrë të drejtpërdrejt të zbatohet përbarimi i detyrueshëm ”, me paragrafin 5 të këtij neni, përcaktohet se: “ Përbarimi i dokumentit noterial mund të kundërshtohet sipas dispozitave të ligjit të procedurës përbarimore ”, ndërsa me paragrafin 6 të po këtij neni, përcaktohet se: “ Në rastet kur dokumenti noterial është dokument përbarimor sipas këtij neni, noteri me kërkesën e palës, vet e vënë në dokument vërtetimin për përbarueshmërinë ”.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë më vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të fakteve të çështjes, ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat ligjore të LPP-së, për arsye se në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka arsyetuar faktet vendimtare përkatësisht Marrëveshja Për Shitblerjen e Aksioneve, me numër LRP.nr.14201/2022 dhe REF.nr.5349/2022 të datës 14.06.2022 nuk është e pajisur me klauzolën e përbarueshmërisë për përbarueshmëri, siç përcaktohet me nenin 43 paragraf 6 të Ligjit për Noterinë.

Të gjeturat dhe konstatimet e bëra si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e atakuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, me çka si i tillë u dashtë që të anulohet dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përbarimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, duke pasur parasysh gjithashtu që me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si më lartë nga gjykata ankimore, ashtu që vendimin të cilin do ta bie do duhet të përmbajë të gjitha elementet e kërkuara ligjore, siç përcaktohet me nenin 160, e lidhur me nenin 175 të LPK-së.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në nenin 3 paragraf 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 194, 208, 209 paragrafi 1 pika d) të LPK-së, e lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr. 8455/2022, me datë 31.05.2024

Gjyqtari
Naim Mehulli, d.v